

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 22, neni 20 paragrafi 1 nënparagrafi 15 dhe neni 96 paragrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44 /14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 19, neni 39 paragrafi 1 nënparagrafi 15 të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 të datës 29.07.2019 dhe pika 28 e Udhëzimit për transmetuesit për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024 (ark.nr.01-1550/1 datë 29.03.2024), dhe në lidhje me nenin 76-v paragrafi 1, neni 75, nenin 75-gj paragrafi 1, neni 76, neni 76-a paragrafët 2 dhe 8 dhe neni 76-b i Kodit Zgjedhor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 40/06, 136/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.98/19, 42/20, 74/21, 215/21 58/24 dhe 76/24), në pajtim me Konkluzionin nr.02-1904/2 datë 15.04.2024, Këshilli i Agjencisë në seancën e 16-të mbajtur më 15.04.2024, miratoi:

### **UDHËZIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT PËR TRANSMETUESIT PËR ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE PARLAMENTARE 2024**

1. Në Udhëzimin për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, ark. nr. 01-1550/1 datë 29.03.2024 (në tekstin në vijim: Udhëzim), pika 7 ndryshohet dhe thotë:

"7. Në total, nëntë minutat dhe tridhjetë sekondat (00:09:30) të kohës reale të programit të transmetimit për reklama politike me pagesë për zgjedhjet parlamentare, parashtruesit e listave do t'i shfrytëzojnë në përputhje me kohën e përcaktuar në nenin 75-gj paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor dhe atë:

- Në maksimum 4 minuta të destinuara për dy partitë më të mëdha politike të pozitës, të cilat fituan më së shumti vota në zgjedhjet e fundit parlamentare, do të transmetohet reklamë politike me pagesë për parashtruesit e listave - KOALICIONI PËR ARDHMËRINË EVROPIANE dhe KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN.
- Në maksimum 4 minuta të destinuara për dy partitë më të mëdha politike në opozitë, të cilat në zgjedhjet e fundit parlamentare fituan më së shumti vota, do të transmetohet reklamë politike me pagesë për parashtruesit e listave - KOALICIONI "MAQEDONIA JUAJ" VMRO-DPMNE dhe KOALICIONI VLEN.
- Në maksimum 1 minutë të destinuara për partitë politike në Kuvend që në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk kanë fituar deputetë mjaftueshëm për formimin e grupit

parlamentar, do të transmetohet reklamë politike me pagesë për parashtruesit e listave - PARTIA E MAJTË dhe KOALICIONI TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË.

- Në 30 sekondat e mbetura të destinuara për partitë politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend apo kandidatët, do të transmetohet reklamë politike me pagesë për parashtruesit e listave:
  - ✓ LËVIZJA E DI - PËR MAQEDONINË TONË;
  - ✓ Partia Politike AVAJA;
  - ✓ PARTIA LËVIZJA CIVILE EVROPIANE;
  - ✓ MAQEDONIA E VETME;
  - ✓ PARTIA ERA E TRETË MAQEDONASE/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT;
  - ✓ PARTIA DEMOKRATËT;
  - ✓ PARTIA POLITIKE E DJATHTË;
  - ✓ PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP;
  - ✓ PARTIA RODINA MAQEDONI;
  - ✓ PARTIA E PUNËTORËVE; dhe
  - ✓ PARTIA JUAJ.”

## 2. Në Udhëzim pika 12 ndryshohet si vijon:

"12. Si porosites të reklamave për zgjedhjet parlamentare duhet të shënohen emrat e parashtruesve të listave të verifikuara të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht listat e verifikuara në vijim:

- ✓ KOALICIONI PËR ARDHMËRINË EVROPIANE;
- ✓ KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN;
- ✓ KOALICIONI “MAQEDONIA JUAJ” VMRO-DPMNE;
- ✓ KOALICIONI VLEN;
- ✓ PARTIA E MAJTË;
- ✓ KOALICIONI TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË;
- ✓ LËVIZJA E DI - PËR MAQEDONINË TONË;
- ✓ Partia Politike AVAJA;
- ✓ PARTIA LËVIZJA CIVILE EVROPIANE;
- ✓ MAQEDONIA E VETME;
- ✓ PARTIA ERA E TRETË MAQEDONASE/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT;
- ✓ PARTIA DEMOKRATËT;
- ✓ PARTIA POLITIKE E DJATHTË;

- ✓ PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP;
- ✓ PARTI RODINA MAQEDONI;
- ✓ PARTIA E PUNËTORËVE; dhe
- ✓ PARTIA JUAJ.”

**3. Në Udhëzim, pika 14 ndryshohet si vijon:**

"14. Nga data 18 prill 2024, me fillimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare, Shërbimi publik radiodifuziv në të njëjtat tri njësi (30%+30%+10%) të lajmeve informon edhe për parashtruesit e listave për këtë proces zgjedhor, gjegjësisht:

- në 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në pushtet, informon për fushatën zgjedhore të kandidatëve për kryetar - Stevo Pendarovski dhe Bujar Osmani, dhe për parashtruesit e listave për deputetë - KOALICIONI PËR ARDHMERINË EVROPIANE dhe KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN.
- në 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në opozitë, informon për fushatën zgjedhore të kandidatëve për president - Gordana Siljanovska-Davkova, Arben Taravari, Biljana Vankovska-Cvetkovska dhe Stevço Jakimovski, si dhe për parashtruesit e listave për deputetë. - KOALICIONI "MAQEDONIA JUAJ" VMRO-DPMNE; KOALICIONI VLEN; PARTIA E MAJTË; dhe KOALICIONI TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË.
- në 10% të kohës për aktivitetet e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për kandidatët e pavarur, informon për fushatën zgjedhore të kandidatit për president - Maksim Dimitrievski dhe për parashtruesit e listave për deputetë - LËVIZJA DI - PËR MAQEDONINË TONË; Partia Politike AVAJA; PARTIA LËVIZJA CIVILE EVROPIANE; MAQEDONIA E BASHKUAR; PARTIA ERA E TRETË MAQEDONASE/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT; PARTIA DEMOKRATËT; PARTIA POLITIKE E DJATHTË; PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP; PARTI RODINA MAQEDONI; PARTIA E PUNËTORËVE; dhe PARTIA JUAJ.”[

**4. Në udhëzim, pas pikës 19, shtohen dy pika të reja 19-a dhe 19-b, të cilat lexojnë:**

“19-a. Kohën prej gjithsej tre (3) orësh, çdo ditë, për përfaqësim politik pa pagesë të fushatave të parashtruesve të listave për deputetë do ta shfrytëzojnë:

- ✓ KOALICIONI PËR ARDHMERINË EVROPIANE;
- ✓ KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN;
- ✓ KOALICIONI “MAQEDONIA JUAJ” VMRO-DPMNE;
- ✓ KOALICIONI VLEN;
- ✓ PARTI E MAJTË; dhe
- ✓ KOALICIONI TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË”.

"19-b. Kohën prej gjithsej një (1) orë, çdo ditë, për përfaqësim politik pa pagesë të fushatave të parashtruesve të listave për deputetë do ta shfrytëzojnë:

- ✓ LËVIZJA E DI - PËR MAQEDONINË TONË;
- ✓ Partia Politike AVAJA;
- ✓ PARTIA LËVIZJA CIVILE EVROPIANE;
- ✓ MAQEDONIA E VETME;
- ✓ PARTIA ERA E TRETË MAQEDONASE/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT;
- ✓ PARTIA DEMOKRATËT;
- ✓ PARTIA POLITIKE E DJATHTË;
- ✓ PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP;
- ✓ PARTI RODINA MAQEDONI;
- ✓ PARTIA E PUNËTORËVE; dhe
- ✓ PARTIA JUAJ.”

5. Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

**Nr. 01-1911/1**

**15.04.2024**

**Shkupi**

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**